



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 22-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 15.09.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Valon Pacolli, DEZH
5. Shkelzen Hajdini, DSH
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Rexhep Rexhepi, DBP
9. Rasim Hasani, DA
10. Safete Amerrlahu, DGJK
11. Burim Rrustemi, DSHPM SH
12. Imri Semetishti, DUPMM
13. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha ju uroj që keni kaluar mirë në pushime, po ashtu tha uroj suksese dhe pune ta mbar ne dhe ne pjesën e dyte, pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për miratimin e Buxhetit për vitet 2024-2026.
3. Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin buxhetor për vitet 2024-2026.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për monitorimin e zbatimit të Hartës Zone të Komunës për periudhën 3 korrik 2022-3 korrik 2023.
5. Propozim Vendim paraprak për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërive të Komunës në ZK Konjuh.
7. Propozim Vendim për ndarjen e burimeve financiare për Islamin Relief Worldwide Office në Kosovë (IRW).
8. Propozim Vendim për përcaktimin e festivalit “Mërgata Fest” si festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

9. Propozim Vendim për përcaktimin e festivalit “Rinia Fest – Lipjan” si festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

10. Raporti i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorive Komunale Janar-Qershor 2023.

Pastaj tha se do ta keni edhe një pike shtesë ashtu siç ju kemi njoftuar edhe më herët e për të cilën po i a kaloj fjalë drejtorit të buxhetit Latif Ramdanit I cili e ka një propozim për rend të ditës.

Latif Ramadani, tha se, se une e propozoj një pike të rend të ditës propozim vendim për rialokimin dhe transferrin e mjeteve të buxhetit për vitin 2023, dhe kërkoj që kjo pike të jetë pas buxhetit em radhë

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se pika,

2. Propozim vendim për rialokimin dhe transferrin e mjeteve të buxhetit për vitin 2023, propozoj që të jetë pika e 3-te e rendit të disa pasi që lidhet me buxhetin.

Pastaj Kryesuesi qiti në votim propozim që hyj në rend të ditë dhe të aprovojë rendi i ditës.

Me të gjitha votat për 29 u aprovua rendi i ditës. .

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se në emër të grupit të PDK-së, iu uroj nxënësve fillimin e vitit të ri shkollor. Pastaj tha se kam disa pyetje dhe kërkesa të qytetarëve, e para ka të bëjë me një shqetësim të qytetarëve të cilët i kanë lokalet në sheshin e Lipjanit të cilët shqetësohen dhe ngacmohen nga një qytetar në shesh i cili si duket ka probleme me shëndetin mendor, kërkesë e këtyre qytetarëve është që të merren me këtë rast deri sa nuk ka ndodh diçka me të madhe. Kërkesa e dytë ka të bëjë nga një banor i fshatit Medvec për asfaltimin e rrugës. E treta nga banorët e lagjes Osmani në fshatin Babush të cilët kanë parashtruar ankesë për asfaltimin e rrugës në vitin 2021 dhe deri më sot nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Kërkesa tjetër ka të bëjë për bllokimin e kanalizimit në fshatin Gllogovc. Tjetra kërkesë ka të bëjë me banorët e fshatit Banullë për rregullimin e trotuarit, pasi që aty po është rrezik. Kërkesa e 6-të vjen nga banorët e fshatit Gllavicë ku sipas tyre deri para këtij viti ka qenë një klasë parashkollor ndërsa tani është mbyllur dhe po detyrohen të dërgojnë fëmijët në Gadime. A do të ketë një zgjidhje për ta. Po ashtu kam edhe një shqetësim për DKA-në, zvogëlimi i nxënësve në shkollat e fshatrave të komunës tonë është shqetësuese dhe shkakton kryesor e shoh shpërnguljen nga fshati në qytet të qytetarëve dhe migrimi jashtë Kosovës ku ka rrezik

qe edhe disa shkolla të mbyllen për shkak te numrit te vogël te nxënësve. Dhe për këtë DKA-ja, duhet te marr masa konkrete qe nxënësit te vijon mësimin aty ku jetojnë e jo te shkojnë ne shkollat e qytetit. A ka DKA-ja, ndonjë strategji për ta ndalur këtë nëse po na tregoni. Kërkesa tjetër hedhja e mbeturinave ne komunën tonë është alarmante, pyetja ime për drejtorin e Inspektionit është cila është strategjia juaj qe te ndalen këto dukuri negative. Tjetra ka të bëjë me dy stadiumet te cilat ende janë me shirita nga prokuroria dhe kanë mbet ne gjendje te mjerueshme, Çka është duke ndodhur me këto stadiume, cilat janë hapat e ekzekutivit lidhur me këto stadiume pasi janë në gjendje të mjerueshme. Pyetje për nënkryetarin e komuniteteve, është një familje e komunitetit në AMF në Banullë, nuk dihet nga kanë ardhë, fëmijët e tyre nuk vijojnë mësimin, i kanë kushtet shumë te këqija por nuk i ka ardhja askush ne ndihmë asaj familje. Dhe pyetja e fundit për kryesuesin e kuvendit, për çka janë të vendosur këta televizorët në sallën e kuvendit pasi qe sa kohe janë këtu dhe nuk e dimë se për çka janë vendosur?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se këta televizor janë vendos me qellim qe te bëhet votimi ne mënyre elektronike.

Shahadije Dragaçina, tha se pyetja ime ka të bëjë me nxënësit e shkollë fillore në Blinajë, pse ekzekutivi ka marr vendim pa i pyetur prindërit qe nxënësit e kësaj shkolla nga klasa 6-9 të barten në Magure edhe pse prindërit e kanë kundërshtuar këtë. Pyetja e dytë është thënë nga ekzekutivi se ne atë shkolle renovimi është bere nga A deri zh, por aty ajo shkolle është ne gjendje shumë te keqe. Dhe e fundit ka të bëjë me asfaltimin e rrugës Vehbi Kozhani, në Ribar të Madh ku sipas qytetarëve aty punët janë bere keq, nuk e di a është mbikëqyrur ajo rruge nga dikush ose jo?

Egzona Bytyqi, tha se unë do te filloj me disa propozime për ekzekutivin, edhe pak do te hyjmë ne muajin tetor dhe i pari propozim është qe ky muaj te ketë ligjërata, broshura dhe aktivitete muaj aktiv, për informimin e popullatës lidhur me natyrën e sëmundjes, propozoj qe traget me qen vendet rurale ose lokalitet e mëdha. Propozim kam për sektorin e diagnostifikes qe te caktojnë një orar për te gjitha ato gra dhe vajza qe dëshirojnë me realizo një Ekografi. Propozimi tjetër qe e kam për QKMF-në, me arrite një marrëveshje me komunën e Drenasit për pacientet e Shalës dhe fshatrave për rreth qe vizitat te behën në Komoran pas orës 20:00 për të mirën e këtyre pacienteve. Pyetja tjetër ka te bëjë me DKA-në, rreth mësimi shtesë për komunitetet Rom Ashkali, Në Magure e cila është mbyllur, ku këtu kane vijuar mësimin afër 60 nxënës. Pse është mbyll kjo klasë? Pyetja tjetër për DKA-në, a është bërë përgatitja me lende djegëse për shkollat e komunës tonë. Formimi i parqeve shumë pune e mire qe po vizitohen nga te rinjtë por kam edhe një propozim qe te behën te parqet edhe mini

bibliotekat. Dhe e fundit shqetësimi që e kam për ta ngritur të disa të banorëve të Magurës për ndërtesat e AKP-së. Unë propozoj që komuna me i thirrë ata banorë dhe me diskutua pasi që është kërkesë me prioritet për këta banorë.

Fadil Spahiu, tha se kam një kërkesë për ekzekutivin, djegia e hamullorëve pas korrje-shirjeve edhe këtë vit po vazhdon të jetë problem i njëjte si në të kaluarën, ku vetëdijesimi i qytetarëve është ende i ulët, e që si pasojë e djegës së tyre për pos dëmit direkt që i shkakton florës dhe faunës së tokës dhe mjedisit po shkakton edhe dëme të tjera bizneseve dhe ekonomive familjare. Kërkoj nga ekzekutivi që të ndermirren masa të sensibilizimit të fermerëve, me anë të kontakteve të drejtpërdrejta ose edhe fushatave të tjera në rrjetet sociale të njoftohen fermerët se cilat janë efektet negative që shkakton djegia e tyre. Në mënyrë që në të ardhmen të ndërpritet ose të zvogëlohet kjo praktikë jo e mirë e djegies së hamullorëve.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se pasi që jemi në fillimin e vitit të ri shkollor kam disa çështje për DKA-në, e para disa këshilla të shkollave kanë filluar inicimin për blerjen e uniformave të nxënësve për shkollë, do të ishte mirë që kjo ide të përkrahet, nga të gjitha shkollat e komunës së Lipjanit si dhe komuna ti subvenciononte të paktën 50% për shkak se është e ngarkuar barra për prindërit. E dyta prapë për DKA-në, çdo ditë shkolla “ Vëllezërit Frashëri” po ngarkohet në Lipjan, ku kryesisht nxënësit po vijnë nga fshatrat dhe komuna duhet të ju bëjë një zgjidhje dhe disa nxënës të shkojnë në shkollën Ismail Luma. Çështja tjetër ka të bëjë me drejtorin e infrastrukturës, ku banorët e fshatit Akllap, është asfaltuar një rrugicë por nuk është shtruar shtresa e fundit, a do të shtrohet shtresa e fundit në atë rrugë ose jo.

Lulzim Rustemi, tha se ju uroj sezonin e ri duke ju uruar punë të mbare dhe rezultate. Kam disa pyetje e para në rrugën “Shefki Salihu” në Lipjan ka dy javë që nuk funksionon. Tjetra në disa lokalitete nuk po ndalet hiç ndriçimi publik në shumicën e rrugëve gati tërë ditën dhe duhet të kontrollohen kjo. Po ashtu ka një kërkesë dhe ankese nga sportistët e komunës së Lipjanit se rregullorja për ndarjen e subvencioneve nuk po respektohet. Duhet të përfillet rregullorja dhe të kemi rezultatet. Kam cekur edhe me herët dhe po e përsëris që drejtorati për Bujqësi he Ai për Zhvillim Ekonomik të sjellin listën e pronave të bujqësisë të cilat janë komunale, të cilat duhet të jenë në menaxhim të komunës dhe të merren nga ata që kanë vullnet për punë. Ujësijellësi në fshatin Shalë është në gjendje jo të mirë dhe duhet komune të merret me atë çështje. Për shkollën e Kraishtës ka një ankese pasi që nuk ka ajo shkollë hiç trotuar dhe duhet të bëhet një zgjidhje. Pyetje, për projektin për parkun qendror dhe parkingun nëntokësor sa ka qenë kosto e shpronësimeve. Dhe e fundit është mirë me u përcjell ekzekutivi dhe punëtorët e administratës për hyrje daljet, e jo me u

shëtit gjate kohës se orarit te punës. Bartja e nxënësve nga shkolla fillore “Vëllezërit Frashëri” te ajo e mesme është gabim fatal dhe nuk keni bere zgjidhje. E vetmja zgjidhje për qytetaret e komunës tonë është ndërtimi i një shkolle fillore ne Lipjan

Alban Salihu, tha se ekzekutivi ditëve te fundit ka marr vendim qe te barten nxënësit e shkollës “ Vëllëzerit Frashëri” nga kalsa 6 deri 9 te ajo Adem Gllavica, e i cili vendim po kundërshtohet nga disa prindër. Kryetari i komunës në vitin 2017, pat premtuar ndërtimin e një shkolle e te cilën asnjëherë nuk e realizoj. Po ashtu kemi edhe ne fshatra afër qytetit me numër te vogël ne nxënësve për shkak te cilësisë se dobët te mësimit dhe mënyrës se rekrutimin te mësimdhënësve. Çështja tjetër ka te bëjë me ndezjen e një zjarri afër fshatit Banullë i cili zjarr po përsëritet dhe po i shqetëson banorët e asaj pjese. Kërkoj nga drejtorja e inspektoratit te merret me atë çështje.

Ardit Cani, tha se kam disa kërkesa dhe çështje për ti ngritur, e para kur do te filloj asfaltimi i rrugicave në fshatrat Baincë Risinovc dhe Shalë. E kam një kërkesë te lagjes Dugolli ne Vrellë për asfaltimin e disa rrugica. Po ashtu një kërkesë banorëve te lagjesh Vuniqi, ne Magure për asfaltimin e rrugicës se tyre. Tjetra ka të bëjë me hapjen e kanalizimit ne fshatin Baincë.

Albiona Tasholli, tha se në emër të grupit të LDK-ë, kemi bërë kërkesë me shkrim për emërimin të parkut qendror me emrin e Dr. Ibrahim Rugova i cili është një lider i jashtëzakonshëm dhe i pa diskutueshëm dhe simbol i paqes, propozoj qe parku qendror te emërohen me emrin e dr Ibrahim Rugova. Po ashtu edhe vazhdimi i sheshit të emërohet me emrin sheshi i “Dëshmorëve dhe Martirëve “Po ashtu propozojmë qe palestra sportive të emërohet me emrin e “Ramiz Shalës” këtë kërkesë do ti drejtojmë komisionit për emërimin e rrugëve.

Rinor Murati, tha se siç dihet bujqësia është veprimtaria kryesore e disa qytetarëve të komunës tonë, andaj përkrahja e tyre është shumë e mirë siç ke rasti i fundit me makina bujqësorë. Po e kam edhe një propozim pasi qe tani hapet konkursi për granate në Ministrinë e Bujqësisë, qe te hiqen taksat administrative me të cilat ngarkohen fermerët përfitues për ndërtim te fermave për kultivim të gjedheve. Përkatesisht taksat administrative për leje ndërtimore për shndërrim te tokës bujqësore ne ndërtimore dhe leje mjedisore , pasi qe këto taksa po i ngarkojnë fermerët përfitues.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se do te mundohem te iu përgjigjem pyetjeve të anëtareve te kuvendit, duke filluar nga ajo e shqetësimit te qytetarëve ne

sheshin e qytetit nga një qytetar, ajo mendoj qe është çështje e policisë. Policia duhet te merret me të dhe te ndërmarr masat. Asfaltimi i një rruge me Medvec kemi një problem pronësor. Asfaltimi i rrugicave ne Babush është në proces. Kanalizimi dhe trotuari ne Gllgovc dhe Banulle do te shikohet ne rishqyrtim te buxhetit. Çështja e ndezjes se zjarreve inspekcioni ka shqiptuar disa here gjoba, por kërkoje dhe bashkëpunimin tuaj. Stadiumet do të përfundojnë shpejt. Televizorët ne sallën e Kuvendit shume shpejt do te funksionalizohen. Projekti i rrugës në Ribar të Madh, është një rrugë e kompletuar me trotuar me ndriçim dhe shenjezim e kompletuar. Propozimet për muajin tetor kenë propozime te mira dhe drejtorja e shëndetësisë do ti marr edhe këto propozime. Sa i përket bashkëpunimit me komunën e Drenasit, deri me tani nuk kemi arrit mirëkuptim qe banoret e kësaj pjese te shkojnë në Komoran. Objektet e AKP-së, në Mgaure kemi pas takim dhe kemi shkresat qe kemi derzuar për rrënim qe aty te behet një park për banoret e asaj ane. Këtë vit kemi me pak zjarre fushore me krahasuar me vitet e kaluara, ndërsa zjarri ne Banullë është një zjarr aksidental nuk ka qenë i qëllimshëm. Rruga në Akllap është e përfunduar. Sa i përket subvencionet e klubeve sportive ne kemi përsërit shpalljen publike për herën e 3te tani. Ndërsa sa i përket pronave bujqësore, lista e zhvillimit ekonomik është publike, dhe ato bujqësorë janë evidentuar te gjitha. Sa i përket emërimit te sheshit dhe parkut nëntokësor është një projekt shume i madh dhe për te sa ka kushtuar do te ju njoftoj kryetari pasi qe është një projekt gjigant. Asfaltimi i rrugicave ne Resiovc ,Baince dhe disa fshatra tjera do te fillojnë shpejt. Sa i përket buqëve ne jemi mbështes për bujqit ne kemi shpendra afër 400 mjete për bujqësi dhe do te kemi dhe mbështetje tjera.

Rasim Hasani, tha se unë nuk e dije se si mund ta ndalim migrimin nga fshati ne qytet, ne po mundohemi ti bëjmë kushtet e njëjtë për nxënës si ne qytet ashtu edhe ne fshatra. Sa i përket shkollës Gallvice Marevc, nuk kemi pas parashkollor asnjëherë, aty një mësuese ka marr një vit me vullnetin e saj. Ata fëmijë do te shkojnë ne Gadime dhe transportin e sigurojmë ne. Shkolla e Blinajës, edhe vitin e kaluar ata nxënës kane qene ne Magure, dhe atje ka mësim me cilësor. Qendra mesimore ne Magure, nuk ka qenë e komunës por është menaxhuar nga një organizatë Vorae, e cila nuk ka pas me fonde dhe është ndërprere por tani prapo pritët te filloj. Sa i përket uniformave jemi informuar por nuk jemi përzier, me i subvencionua uniformat nuk kemi mundësi. Pse po vijnë nxënësit ne “Vëllezërit Frashëri” ata po janë ne rregull me letra dhe ne nuk mund ti ndalim.

Shkelzen Hajdini, sa i përket familjes në Banullë, janë njoftuar organet e rendit dhe ato po merren me rastin. Sa i përket muajit Tetor, ne do te organizojmë kampanja vejdusuese edhe kemi planifikuar disa aktivitete. Do te organizojmë edhe kryerjen e

testeve te mamografise. Te diagnostika do te shohim se çka do te mund te bëjmë. Ne do te jemi te angazhuar për te mirën e qytetarëve.

Arsim Jashari, tha se nuk besoj qe ka ndonjë anëtar te kuvendit qe bashkëpunon me shumës e unë me drejtorinë e inspektoratit. Unë pata pyetje për drejtorin e shëndetësisë a ka marr leje ajo familje nga ana juaj qe te banojnë ne AMF në Banullë. E kam edhe një propozim komisioni për emërimin dhe riemërimin e rrugëve e ka përfunduar punën dhe këtu ligjërisht po e shoh një problem, ai vendim duhet te vije ne kuvend te votohet komplet, por unë e kam një propozim qe me bo një vendim për emërimet e vjetra dhe për riemërimet e reja.

Alban Salihu, tha se na vazhdimisht diskutojmë për dërgimin e nxënësve ne shkollën “Vëllëzrit Frashëri” me arsyetimin e prindërve se cilësia e mësimi ne atë shkollë është me e lartë, tash ne po konstatojmë qe njëra për zgjidhjeve ndoshta do te ishte me bërë shkëmbimin e mësimdhënësve në shkollën tjetër te qytetit . Si DKA, mund te ketë mundësi dhe metoda te ndryshme qe me zgjidh këtë problem, por kjo mund të bëhej prej një drejtori qe do te ishte i përkushtuar, e nuk mund të bëhet prej një drejtori qe e kam thënë edhe një herë qe keqpërdor furnizimet e shkollave me drunjtë, do me thënë ky vjedh edhe me furnizimin me drunjte ne shkolla ,e po ta zgjedh problemin e arsimit në Lipjan.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha se keni kujdes deklaratimet qe po i bëni në kuvend.

Shahadije Dragaçina, tha se sytë janë për me pa, juve ndoshta ua kanë bërë rafsh ata banorë, por aty shihet qe nuk ka pas aspak cilësi asfaltimi i asaj rruge. Dhe nëse po thoni qe ka pas cilësi ajo rrugë pse prape është përfshire konstruktimi i rrugës së “Vehbi Kozhani”.Pse ka nevojë prape te investohet ne atë rrugë.

Rasim Hasani, tha se mirë është me fole, por duhet me i mbajte fjalët, e jo pastaj mos me qajtë neper gjykata.

Ganimete Qeriqi, tha se unë po lidhna me propozimin e koleges për personalitetit e Ibrahim Rugovës, qe e përshkruajti profilin e Rugovës plotësisht pajtona me Albionen , por po te ishte ne jetë Ibrahim Rugova, apo do te kishte mundësi qe ta linte një testament, ai kishte me thënë qe asnjë shesh tjetër te mos emërtohej pos emrit të Shtjefën Gjeqovit.

Egzona Bytyqi, sa i përket kronologjisë se këtyre klasave të mësimi shtesë në Magure , problematike qenka çështja financiarë, siç duket.Është mire qe drejtorati i

shëndetësisë me kërkesë zyrtare me ju drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë që në agjendën e Mamografit me e fut edhe komunën e Lipjanit.

Dimant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se, te rruga në Ribar të Madh, ne kemi kërkuar testet për cilësia dhe sasi dhe ato janë përmbush te gjitha. Dhe asnjë cent me shumë nuk do te bëhet. Ndërsa transferimi i mësimdhënës ne shkollën tjetër është ofendim për atë shkollë.

Alban Salihu, thash që ekziston një mendim ne Lipajn që cilësia “Vëllezërit Frashëri” është më e mirë dhe pasi që jemi me një situatë ku mbi 40 nxënës janë me një klase, ne duhet të bëjmë një zgjidhje, pasi që s’mundemi me i lenë ashtu. Një zgjidhje kish mujt me kanë tu i shkëmbye e jo me i lenë ka 40 nxënës në klasa. Në Banullë nga vij unë janë nga 10 nxënës në klasa dhe duhet të bëhet një zgjidhje. Unë asnjëherë nuk fola për cilësinë e mësimdhënësve ne shkollën “ Ismail Luma “

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, e para riemërtimet e shesheve, nuk e di vendimin e saktë si është, me sa e di unë do te vendosen emrat vetëm të atyre rrugëve që nuk kane emra. Ndërsa sa i përket rrugës “Vehbi Kozhani” është përfunduar dhe nuk do te shtohet me asnjë cent për atë rrugë, kontrata është publike dhe është ne veb sajdin e komunës dhe ço kush mund ta shesh. Sa i përket cilësisë na i kemi dëshmitë nga kompanitë te cilat janë te licencuara nga ky shtet. Shkolla fillore në Lipjan, është problem, pasi kryesisht banesat janë ne qytet dhe kryesisht qytetaret vijnë ne zonën e parë, problemi i dytë qytetaret nga fshataret vijnë me një dëshmi që janë duke banuar ne qytet, dhe i treti ne e kemi bere vet duke thënë që ne shkollat tjera nuk ka cilësi ne vet e kemi ndërtuar atë mendim edhe këtu ne këtë kuvend ka pas asi tendenca. Nuk jena na ekspertë ,unë jam menaxher që e menaxhoj me punët e komunës. Une nuk merrem me akuza te kota kryetari i komunës e emëroj këtë familjar në këtë shkollë apo ne atë shkollë. Ju lus që te keni kujdes që fjala publike, sepse kjo nuk ndikon ne te mirën e qytetarëve. Çështjen e rrugëve do ta diskutojmë ne kuvend. Politiken duhet ta bëjmë deri në atë masë që mos ta dëmtojmë qytetarin.

Alban Salihu, na këtu po konstatojnë që gjendja është keq në shkollë, asgjë me shumë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se dikush po ia ep të drejtën vetes me u bere ekspert, prokuror gjykatës. Dikush e tha këtu në kuvend, për dikë që ka vjedhur filan vendin. Unë e kam një pyetje? Disa kocka i patëm jek nga rruga te shkolla. Ku janë ato kocka a e dini kush? Ato kocka janë në oborr të Alban Salihut

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Arsim Jashari, tha se kam një vërejtje te procesi pasi që po shënohen ne ekstrat emrat e drejtorve te cilët nuk po janë prezent ne mbledhje.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se do ta shohim këtë vërejtje.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 21 e Kuvendit ,me veretjet e cekura me lart pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 25 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 21-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për miratimin e Buxhetit për vitet 2024-2026.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Besiana Sylja, tha se siç shihet ne bazë të tabelave buxheti këtë vit është mbi 23 milion euro, nëse e bëjmë një krahasim me vitin 2022 kemi rrënjë mbi 3% ndërsa kemi ngritje ne mallra dhe shërbime mbi 80%. Kjo po tregon se buxheti me shume është i koncentruar ne konsum se sa ne investime. Dhe kjo tregon qe do te kemi suficit ne fund të vitit , pasi qe buxheti behet duke bere analiza e jo pa ber kurrfarë analize. Çka është brengose te investimet qe shihet pasi një kohe qe kryhen punët shihet të metat e investimit. Kërkoj na ana juaj qe investimet kur te kryhen te kryhen me mire te mbikëqyren nga dikush dhe te jene me te qëndrueshme jo te prishen menjëherë.

Arsim Jashari, tha se me sa po shihet në këtë buxhet nuk është marr parasysh asnjë propozim të cilin e kemi dhënë në anëtarët e kuvendit e as qytetarët. Planifikimi i buxhetit duhet ti përmbajë disa parime ku duhet ti marr për bazë kërkesat e grupeve të marginalizuar të shoqërisë dhe të jetë gjithëpërfshirës, si dhe të merren parasysh nevojat e shoqërisë. Nëse e shikojmë ky buxhet më shumë është elektoral se sa gjithëpërfshirës, krejt buxheti është caktuar në 3 apo 4 kode. Pra i gjithë buxheti është elektoral. Unë e kam bërë një kërkesë specifike për fshatin Banullë për shkollë e të cilën me keni premtuar që do ta kryeni tash e keni fut në buxhet në vitin 2025 e ajo shkolle nuk mundet me mbijetua deri në atë kohë. Në grupi i PDK-së, nuk mundemi me votuar një buxhet të tillë.

Armend Grajqevci, tha se në emër të grupit të LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim, ku ky buxhet është reflektim i nevojave dhe prioriteteve si institucion komunal, andaj miratimi i këtij buxheti do të sjell përparime ekonomike dhe projektet të mëdha. Projektet tjera do të përfshihen dhe përmes donatorëve në projekteve të tjera.

Alban Salihu, tha se kemi të bëjmë me një buxhet jo kreativ dhe gjithëpërfshirës ku buxheti ndahet për disa projekte, e kur dihet që në komunën tonë shumë fshatra përballen me probleme elementare. Disa asamblistit të këtij kuvendi kemi ngritur disa çështje për fshatin Banullë, siç janë shkolla brenda fshatit, shkolla e madhe, një urë dhe disa projekte të tjera dhe asnjëra nuk është marr parasysh. Ndërsa janë nda afër 1 milion euro për stadiumet e të cilat me herët janë përmendur si të përfunduara. Përfundimisht në si grup i VV-së, nuk e votojmë këtë buxhet pasi që nuk i përbush nevojat e qytetarëve.

Fadil Spahiu, tha se në mbledhjet e kaluara të Kuvendit Komunal unë i kam ngritur disa kërkesa të qytetarëve si dhe në mbledhjen që është aprovuar korniza afatmesme buxhetore i kam dhënë disa propozime për projekte shtesë të cilat projekte kanë qenë të qytetarëve e që rrjedhimisht është dashur të futen në tabelën e planit 2024-2026, me që asnjë nga këto projekte nuk është futur në këtë tabelë unë nuk do ta mbështes këtë Propozim Vendim. Por për hire të planifikimit të projekteve tjera unë do të abstenoj.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se në anëtarët e kuvendit kemi marr pjesë në disa dëgjime buxhetore në qarkoren e parë dhe aty kemi dhënë disa propozime për projekte dhe asnjëra nuk është marr parasysh dhe unë për arsye e kam abstenuar debatin e dytë pasi që kërkesat e mijë nuk po merren parasysh. Komuna ka parapare shtigje të ecjes në disa fshatra por këtë nuk e ka parapare në Shalë, pse nuk është

parapare ne Shalë te Gryka e Shalës pasi qe është aty një vend shumë i mire qe te behën shtigjet e ecjes, do te ishte mire qe komune me i e përfshi shtigjet e ecjes në Shalë. Po ashtu te shtatorja e Uran Amerllahut te jetë një park rekreacioni, ku qytetaret aty do te pushonin dhe do te zhvillonin aktivitetet.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se momentin qe e kërkon fjalën kryetari apo dikush nga ekzekutivi unë ia kaloj fjalë, është mirë me lexua rregulloren e punë së kuvendit.

Shahadije Dragaçina, tha se ajo qe për mua është shqetësuese në këtë buxhet është planifikimi i projekteve sa për zhurmë ndërsa shtyhen vit për vit, siç është rasti me ndërtimin e disa rrugëve si ajo Teqe-Shushicë, në Honrovc, në Vugoqicë dhe për këto projekte u patën gëzuar qytetarët, ndërsa tani kryetari i komunës këto projekte i ka shtyrë ne vitin 2026 dhe kjo i ka dëshpëruar qytetarët. Këto projekte janë shtyrë ne ketë vit pasi qe është vit zgjedhor dhe qëllimi i kryetarit ka qenë ky. Pra kemi një kryetar i cili nuk i merr parasysh kërkesat e qytetarëve .

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, është normale me pas ide propozime, dhe duhet me kuptua qe pushteti e bën buxhetin. Kur e kam bërë shtegun e ecjes në Lipjan shumë nga ju kanë thënë çka po ju duhet pse po ndahen mjete për të. Kur i kam bere lidhjen me asfalt ne mes te disa fshatrave shumë nga ju kanë thënë çka po ju duhen këto. Po ashtu edhe sheshin kur e kam bërë dikush e ka quajtur varreza të Lipjanit dhe nuk e ka votuar. Unë kam marr përgjegjësi për ta udhëhequr me qytetarët e komunës së Lipjanit dhe do ti realizoj ato, premtime te cilat i kam dhënë në fushatë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ju kisha lut te gjithë mos ndërhyjni nga vendi, unë ia jepi fjalën secilit qe e kërkon, vetëm respektoni atë qe flet pastaj ua kaloj fjalën juve.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha kur bisedoj unë nuk ka nevojë me ndërhy askush, unë nuk e kam fyer askënd, ju e keni ne youtube deklarimin e partive tuaja politike ku e kanë quajtur sheshin varreza. Unë në buxhetin e kaluar i kam marr për bazë 3 propozime tuajat dhe buxhetin e kemi ndërruar ne Kuvend dhe ju nuk e keni votuar. Atë qe ua kam thënë qytetarëve lipjanas do ta realizoj, ju them se shumë shpejt do të jeni në inaugurimin e Parkut të Madh të qytetit të Lipjanit, të Parkingut Nëntokësor dhe të Sheshit të Qytetit. Unë e kam një premtim elektorale i cili është edhe publik, qe secila familje do ta ketë asfaltin te dera dhe do ta mbaj këtë qëndrim, me përjashtim te atyre qe refuzojnë ti dhënë pronat e veta. Ne agjendën tonë kemi edhe projekte të tjera me donator qe do te vazhdojmë me punët në teren. I kemi zgjedh

shumë probleme afatgjate te qytetarëve dhe do ti zgjedhim siç është parkingu nëntokësor, parku i madh i qytetit, QKMF-ja, dhe do ti kryejmë të gjitha. Sipas juve janë prolonguar disa rrugë në fshatra po apo harron që edhe Lipjani është i Kosovës ndoshta qeveria bjene dhe ne Lipjan ndonjë projekt.

Arsim Jashari, tha se, është mandati i 3-të i yti si kryetar dhe i përfaqëson qytetaret e komunës së Lipjanit, mirëpo nuk ke të drejtë ti thuash anëtareve të kuvendit mshale? Sa jam boss dhe kontribut dhënës e dine të gjithë qytetarët e komunës së Lipjanit dhe nuk i tutna askujt, kur ka qenë koha me dal ne teren kam dal. Unë te respektoj si kryetar dhe jam ne mesin e atyre që çdo here te flas, mirëpo me më thënë mshile nuk të duroj?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se për kontributin ne kohën e luftës ta epi dorën ndërsa për atë që po e bënë këtu, as 5 pare nuk i epi për ty? Ti nuk e din as për çka e kam pas fjalën.

Arsim Jashari, tha se kush i ep 5 pare e kush nuk i ep ti mendon ashtu, por as unë nuk i epi për ty? Unë te kam respektua dhe vazhdoj te respektoj sa je kryetar. Por unë po te them mos me ofendo se nuk te lejoj me më ofenduar?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, unë e di për atë rastin ne bilardon dhe mos fol se te bjen keq.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ju kisha lut mu kthi ne tem mos bisedoni jasht temës.

Arsim Jashari, tha se këtu është vendi i anëtareve te kuvendit për te diskutuar anëtaaret e kuvendit e jo i ekzekutivit.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ky është edhe vend i anëtareve te kuvendit por edhe i ekzekutivit, unë po ju them mos flisni nga vendi sepse fjalën do te ia kaloj te gjithave kushdo që lajmërohet për fjale.

Alban Salihu, tha se kryetari i Lipjanit është mjeshtër i keqinformimeve dhe i keq citimeve çka themi ne. Ne nuk jemi kundër ndonjë projekti specifik, pasi që ne fshatra ka nevojë për investime. Tjetra nuk është mirë me përfshi familjen ne debatë se nëse keni dyshime dërgoni policinë, por mos u mundoni me përfshi një familje që ton jetën u mundu duke punuar pune private dhe nuk janë të gjitha familjet e inkriminuara siç është familja jote ku asnjë tender dhe asnjë kontratë nuk jepet në Lipjan po u përfshire djali yt.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se janë do prind diku qe kanë pranuar te punojnë nën masa të dhunshme . Ndërsa sa për fjalën qe ju e thatë shihemi në gjykatë argumentoje tani këtë punë, por mos qaj tani qysh ke qajtë.

Albiona Tasholli, tha se nuk e di si mundeni me qen kundër një kryetari i cili ka vizion, një lider i mrekullueshëm, produktiv dhe inspirues për opozitën.

Lulzim Rrustemi, tha se është mirë me diskutua rreth pikës ne te cilën jemi rreth buxhetit dhe secili mund ti ep idetë e veta propozimet e veta, por prapa është kuvendi ai qe vendos a do te kalojnë ose jo. Por na duhet me pas sjelle te mira si anëtar te kuvendit por edhe si ekzekutiv sepse qytetaret na kane përzgjedh dhe presin përfaqësimin tone. Sa i përket buxhetit qe e kemi marr kemi një buxhet qe vitin 2025 është afër 24 milion euro . Nëse e shikojmë te kategoritë ekonomike kemi një shpërndarje proporcionale vit pas viti. Te investimet kapitale ne kemi pas disa dëgjime buxhetore por pjesëmarrja nuk ka qen e kënaqshme, për vitet 2024, te infrastruktura janë parapare 20 projekte ku janë disa projekte te mëdha, si parkingu nëntokësor parku i madh, vazhdimi i Sheshit dhe disa projekte tjera. Pra për 2 vitet e ardhshme buxheti është koncentruar ne projekt te mëdha. Çka i mungon këtij buxheti, janë, rruga Topliqan-Kojnskë, shkolla fillore e re në Lipjan. Po ashtu mungojnë rekreacione gjelbëruese, ska projekte as për ujë te pijes, ku disa lokalitet janë pa ujë te pijes si Magurë Vrellë, Kraishtë, Bujan, Brus dhe fshatra tjera, mungojnë edhe kabinetet ne shkolla. Nuk është punuar për ujerat e zeza. Buxheti duhet te shpërndahet për te gjithë qytetaret. Ne grupi i PDK-së, nuk e përkrahim këtë buxhet.

Egzona Bytyqi, tha se ne anëtarët e kuvendnit po edhe ekzekutivi e kemi obligim qe kuvendit me shfrytëzua për ti ngritur shqetësimet dhe rekomandimet te cilat i marrim nga qytetarët, e jo kjo foltore për përdoret për fyerje e për inate personale dhe kjo është tejet e ulet dhe e pa pranueshme. Nuk bon qe ky fjalor te përdoret ne kuvend. Ndërsa sa i përket propozim vendimit për buxhetin unë e kam një propozim qe ato projekte te cilat e atakojnë fshatin tim Qylagë pata propozuar qe te futet shtrati i lumit në Qylagë por ky projekt është parapare ne vitin 2026 , është mirë qe ky te futet me herët ne buxhet pasi qe është shumë i domosdoshëm për fshatin tonë.

Bashkim Budakova, tha se i përket propozim Vendim për miratimin e Buxhetit për vitet 2024-2026, e pata marr një këshillë prej një kolegut qe duhet te marr pjese ne dëgjimet publike dhe e pata marr si për te mire atë propozim, mirëpo ne dëgjimet publike kane marr pjese një numër i banoreve të fshatrave Rubofc i Madh, Rubofc i Vogël dhe Kojnskë të cilat mi kanë dërguar mua e te cilat i kam adresuar te ekzekutivi

dhe asnjë kërkesë e tyre nuk është marr për bazë nga ekzekutivi. Prandaj une do të votoj kundër këtij propozimi.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, unë nuk e kam fyer kurrë ata që nuk me ka fyer, ndërsa kush me fyer edhe unë e fyej. Sa i përket buxhetit, ka propozime të ndryshme por cilin projekt me jek që me fut një projekt tjetër, ne me shumë ju kemi dhen rendësi projekteve të mëdha, që janë ne të mirën e qytetarëve. Na të gjithë e dimë që emergjenca është keq, parkingu i madh duhet të bëhet, sheshi duhet të kryhet. Unë pres që do të kemi edhe projekte tjera qofte nga tejkalimi i të hyrave dhe nga donatorët.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për, 10 kundër dhe 2 abstenime aprovoi propozimin

III

Propozim vendim për rialokimin dhe transferim e mjeteve të buxhetit për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit nga DBF , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 9 kundër aprovoi propozimin

Pastaj kryesuesi i kuvendit dha pauze nga ora 12 e 50 deri në 14:00

Kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pjesën e dytë të Kuvendit

IV

Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin buxhetor për vitet 2024-2026.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit nga DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se është shumë shqetësuese që kemi kaq pak qytetari aktive ku marrin pjesë vetëm 120 qytetarë nga 57 mijë banorë sa ka komuna e Lipjanit. Po une e kam një pyetje pse nuk ka interesim të qytetarëve të marrin pjesë në dëgjime publike, a është arsyeja kjo që nuk po ju merren parasysh propozimet e tyre. Tjetra ky raport është i manipuluar, nëse shihni fotot nuk janë askund anëtarët e kuvendit dhe KPF-së, dhe Komitetit për Komunitete, që kanë marrin pjesë në dëgjime buxhetore. A e dini pse nuk është ajo foto, për arsyes se asnjë anëtar i kuvendit nga radhët e LDK-së, nuk ka marrin pjesë në dëgjime publike. Unë mendoj që ky veprim është shumë i ulët.

Armend Grajqevci, tha se ndoshta ka pas një pjesëmarrje me të vogël të qytetarëve në dëgjime buxhetore, mirëpo unë kam marrin pjesë në disa dëgjime neper fshatra dhe e kam par që qytetarët me nuk po din as çka me lyp në dëgjime buxhetore pasi që është plotësuar infrastruktura neper fshatra.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ka qenë pjesëmarrja me të dobët e qytetarëve por, disa nga asamblesitet e LDK-së, kanë marrin pjesë në dëgjime buxhetore. Por a është e kënaqshme kjo pjesëmarrje nuk është e kënaqshme.

Arsim Jashari, tha se unë si shqetësim e ngrita pse nuk është në raport edhe foto ku kanë marrin pjesë anëtarët e kuvendit.

Nexhmedin Lekqiqi, tha se sa i përket raportit është dashtë me qenë edhe fotot e anëtarëve të kuvendit në këtë raport. Por konstatimi se e kam humbur besimin qytetarët nuk është i drejt, fakti është se komuna po punon dhe qytetarët janë të kënaqur me investimet që po bëhen dhe nuk po marrin pjesë.

Arsim Jashari, tha se ajo që po e thotë doktori po i bien që me i jek krejt prej ligjit dëgjimet buxhetore, po harroni që qytetaria aktive ka kuptim shumë të madh, pasi qytetaria aktive ndikon në punën e mirë edhe të ekzekutivit dhe të opozitës.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se obligimi jonë si anëtarë të kuvendit është të marrin pjesë në dëgjime buxhetore. Mandej a realizohet kërkesa tona a jo është diçka tjetër. E vlerëson qytetari tani punën tonë.

Besiana Sylaj, tha se unë e kam një vërejtje të dëgjimeve buxhetore, nuk e di pse mbahen dëgjimet buxhetore, kur dihet që kryetari vet i cakton projektet pa e pyetur askënd. Unë kam marrin pjesë po me nuk marrin sepse asnjë kërkesë e imja nuk është shqyrtuar po edhe qytetarët e kanë kuptuar që nuk realizohet kërkesat e tyre.

Alban Salihu, tha se qytetaret nuk po marrin pjese ne dëgjime buxhetore sepse ju ja keni dhënë ndjesinë qe kërkesat e tyre janë te pa realizueshme, po ashtu edhe kërkesat e anëtareve te kuvendnit nuk janë marr parasysh asnjëherë dhe mënyra e njoftimit behet sa për sy e faqe.

Arsim Jashari, tha se raporti si raport është shumë mirë i strukturuar, ata te cilët e kanë bërë punën duhet me i përgëzuar, vetëm mangësia ke qe nuk është përfshi foto ku kane marr pjese anëtarët e kuvendnit ne dëgjime buxhetore

Latif Ramadani, tha se ne e kemi plotësuar një rekomandim te Demos, për e performancë, dhe nuk është e vërtete qe nuk janë marr parasysh kërkesat e qytetarëve. Ne kemi organizuar dëgjime buxhetore si drejtorat, po ashtu i ka organizuar edhe sektori i kuvendnit se bashku me kryesuesin e kuvendnit dy dëgjime buxhetore dhe ftesat ju kanë dërguar te gjithave por nuk ka pas interesim.

Alban Salihu, tha se nganjëherë veç pse propozojmë ne ndonjë projekt ju për inati nuk i merrni parasysh dhe nuk i vendosni ne buxhet, unë i kam propozuar 3 projekte dhe asnjërën nuk e keni marr parasysh si: një ure ne Banullë, Shkolla e vogël ne Bnauille, dhe shkolla ne mes te fshatit.

Latif Ramadani, tha se shumica e propozimeve qe janë dhënë ne vitin e kaluar janë ne dëgjimet buxhetore vetëm është mire me i lexuar, ndërsa projektet qe po i përmend ti i kemi te listuar dhe do ti përfundojmë

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua ne piken ne vijim.

V

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për monitorimin e zbatimit të Hartës Zone të Komunës për periudhën 3 korrik 2022-3 korrik 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se te ndërtimet po janë të obliguar qe te ju përmbahen kriterëve, mirëpo mos harroni qe një gabim teknik ka ndikuar qe te ndalen ndërtimet ne Lipjan dhe te ikin ndërtuesit nga Lipjani , ku me sa shihet 45 leje te ndërtimit te larte janë refuzuar për arsye se nuk janë plotësuar kriteret. Problemi me i madh është

se sot është shtir me i plotësua kushtet ne baze te këtyre gabimeve teknike për ndërtim te larte, dhe me këtë po dëmtohet buxheti i komunës.

Alban Salihu, tha se disa muaj pas miratimit te hartave zonale, si komune e patëm dërguar një kërkesë ne Ministri për ndryshimin e disa kodeve te hartës zonale, mirëpo Ministria e ka kthye negativ për shkak se e ka zbatuar ligjin. Tash, ne baze te këtij raporti po thuhet qe këto harta kane filluar me gjet zbatim, ne krejt Kosovën kane hyp çmimet por ne Lipjan, për shkak te hartave janë rrit me shume se në qytetet e tjera. Disa ndërtues te komunës se Lipjanit kane ikur ne komunat tjera. Por me sa ka informata lejet ndërtimore ne Lipjan, po i marrin ndërtuesit te aferent me drejtoret apo me zyrtarët e komunës dhe kjo është shqetësuese.

Shahadije Dragaçina, tha se e kam lexuar këtë raport me vëmendje por e kam një shqetësim te rruga Bujan Kraishte ku thuhet qe është përfunduar ndërsa sipas banorëve ajo rrugë nuk është e përfunduar.

Lulzim Rustemi, tha se një pyetje e kam, ne e kemi kundërshtuar ashpër këto harta, A është lëshuar ndonjë leje ku nuk janë zbatuar hartat zonale të Komunës. Për rrugën Bujan Kraishtë, a ka asfaltim te rrugës apo vetëm zhavorrim, sepse aty asfaltim nuk ka.

Imri Semetishti, tha se kriteret janë respektuar çdo here duke respektuar hartën zonale dhe asnjë leje nuk është bere pa kriteret e hartës zonale. Mirëpo tani kane filluar edhe ndërtuesit te i përshtaten kushteve duke i bashkuar pronat. Janë disa gabime teknike qe janë bere, por ato do te shohim ti korrigjojmë pas 4 viteve. Ndërtuesit nuk kane ike, ka edhe ndërtues qe vijnë edhe nga komunat tjera. Këtë vit janë 7 leje për ndërtime te larta. Çdo kush qe është i interesuar dhe i plotëson kushtet pajiset me leje ndërtimore. Asnjë ndërtues nuk ka përfituar leje ndërtimore pa i plotësuar kriteret. Asnjë leje nuk është lëshuar pa i plotësuar kriteret ligjore.

Arsim Jashari, tha se ne baze te hartave zonale tash janë kriteret me ndryshe dhe nuk ka qare pa iu përshtat ndërtuesi. E kam një pyetje për ndërtesën qe është te Centrumi, aty me sa shihet veturën e ndihme se shpejt nuk e nxënë, ai plotëson kriteret ajo a jo.

Imri Semetishti, tha se sa i përket asaj ndërtesë është shqyrtuar çdo detaj si aj si nga zyrtaret ashtu edhe ne grup ekipor. Ndërsa pas zhvillimeve tjera, është përgjegjësi e inspektoratit.

Lulzim Rustemi, apo mundemi të bëjmë zgjidhje për qeshjen e shkalleve emergjence pasi që dihet që shumica e ndërtimeve në Lipjan nuk i kanë shkallet emergjente. Duhet të paket tani këto që po ndërtohen që ti keni shkallet emergjente.

Imri Semetishti, tha se çdo objekt i lart i nënshtrohet pëlqimit nga agjencia e emergjencave, por deri me tani askund nuk po kërkohen shkallet emergjente deri sa kjo nuk behet nga niveli nacional.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se rruga Bujan Kraishtë, kanë qene mjetet e ndara vetëm për zhavorrim, ndërsa këtë vit janë ndarë mjete për asfaltim të asaj rruge.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 11 kundër, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim paraprak për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se në grupi i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim. Por kam një pyetje? Për pagesat e komisioneve a mujua me i dërguar në gjykatë pasi që nuk po paguhen, qysh me punua një anëtar i komisionit pa u paguar. Dhe nuk po me doket shume e drejt me padite komune për diçka që na takojnë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se unë sot i takova zyrën e personelit për të u informuar për mëditjet e juaja se e prita që do të pyet dikush në Kuvend. Edhe ato komunat të cilat i kanë paguar tani me nuk po i paguajnë. Ne i kemi mjetet i kemi dërguar shkresë të gjithë përgjegjësve, me se keni e kemi punën e KKS-së, ku me ligj është obligatorë dhe nuk po mundemi me pagua.

Arsim Jashari, tha se në kemi dërguar një lende në gjykatë, nëse i paguajmë me mallra dhe shërbime, çka mundet me na bo ministria, me i paguar pa i pyetur hiç.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ne nuk po mujna sepse ata po na bëjnë pengese nuk po na lejojnë me i paguar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për 2 kundër, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërive të Komunës në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj, ne emër të grupit të LDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë Armend Grajqevcin.

Arsim Jashari, tha se me këtë ligjin e ri për çdo komision me ndërruar anëtar është jo ne rregull.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se ne grupi i PDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë Lulzim Rrustemin.

Lulzim Rrustemi, te vendimi te komisioni, te neni 6 është mire qysh ka qenë me herët te jetë duhet te paguhen me vlerën e komiteteve obligative.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për 4 kundër, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për ndarjen e burimeve financiare për Islamin Relief Worldwide Office në Kosovë (IRW).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Fadil Spahiu, tha se me qe ndarja e këtyre mjeteve bëhet me qëllim të bashkimit të mjeteve financiare për realizimin dhe implementimin e projektit të përbashkët komfor marrëveshjes së bashkëpunimit të dates: 17.08.2023, e lidhur në mes Komunës së Lipjanit dhe Islamik Relief Worldwide zyra në Kosovë që ka për qëllim jetesën e qëndrueshme dhe gjenerimin e të ardhurave përmes Moto kultivatorëve dhe Serave dhe se përfitues nga ky projekt do të jenë banorët e Komunës së Lipjanit, e mbështes këtë Propozim Vendim.

Arsim Jashari, tha ne grupi i PDK-së e mbështesim këtë propozim vendim pasi qe i prekte nevojat e qytetarëve

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për përcaktimin e festivalit “Mërgata Fest” si festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi drejtor i DKRS, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë pajtona qe ka qenë me te vërtet një festival i mire, por unë i kam dy propozime e para me e fut turnirin e futbollit të vogël si dhe propozimin e doktoreshës Egzonës qe kur te vijne Mërgata, me hap kuvendit dhe me i prit ne kuvend mërgimtarët ose kryesuesi ose shefat e grupeve apo edhe te gjithë anëtarët e kanë mundësi, dhe me u njoftua për aktivitetet tona. Dhe propozimi i fundit te organizohet te shtegu i ecjes pasi qe ne shesh po është pak ngushte. Ne grupi i PDK-së, e mbështesim këtë propozim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se eshët viti i dyta qe behet ky organizim, por do te ishte e mire qe ky te pasurohet dhe me shume me aktivitete dhe disa te behën ne dhe ne fshatra si Gadime, Kleçkë, ne kuadër te këtyre ditëve

Fadil Spahiu, tha se unë, kur e kam parë shpalljen publike në web sajtin e Komunës për organizimin e festivalit të quajtur Mërgata Fest 2023, në mbledhjen e 18 me radhë të Kuvendit Komunal e kam bërë një kërkesë për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport që ky organizim të bëhet tradicional. Kërkesën e kam bërë duke u bazuar në organizimin e vitit të kaluar të këtij aktiviteti që kishte grumbulluar aq shumë qytetarë dhe përveç festivalit muzikorë ishin diku rreth 10 sporte të ndryshme dhe shumë atraktive, e që publiku i priti me entuziazëm dhe kënaqësi, sepse ishte më

ndryshe se organizimet tjera. E kam planifikuar që të propozoj që për ta kuptuar qytetarët më mirë se organizimin Mërgata Fest e përbëjnë edhe sporte të ndryshme emërtimi i këtij eventi të jetë “Mërgata Fest dhe Sport” por me që këtë propozim e bëri Drejtoresha e mbështes në tërësi këtë Propozim Vendim.

Anila Reqica-Llugiqi, tha se ne e kemi parë që është një Festival i mire por, për aktivitete tjera që do të hyjnë në këtë festival do të vendosim ndër kohe por çdo propozim tuajin e mirëpresim. Do të behet thirrja publike dhe aty do të shihet aktivitetet. Sa i përket turnirit ajo duhet të ketë një statut të veçantë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me propozimin që të i shtohet titullit Mërgata Fest & Sport dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për përcaktimin e festivalit “Rinia Fest – Lipjan” si festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi drejtor i DKRS, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Armend Grajqevci, tha se Lipjanit i ka munguar një festival i tillë tradicional, dhe jemi komuna e parë që kemi bërë një festival të tillë. Dhe ky festival ka marrë përkrahje të madhe në grupin e LDK-së, e përkrahim.

Arsim Jashari, tha se mua më shumë më ka pëlqyer festivali për rininë pasi që ka qenë një organizim më i mirë dhe në grupin e PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim.

Fadil Spahiu, tha se E mbështes këtë Propozim Vendim, që Komuna e jonë të ketë një Festival tradicional me titull “Rinia Fest- Lipjan”, sepse mendoj se siç edhe është cekur në arsyetimin e këtij Propozim Vendimi se Dita Ndërkombëtare e Rinisë meriton të festohet në Komunën tonë pasi vlerësojmë që kemi një resurs të pazëvendësueshëm të vendit, rininë tonë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, aprovoi propozimin

XI

Raporti i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorive Komunale Janar-Qershor 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën z Imri Ahmetit, kryetar i komunës së Lipjanit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorive Komunale Janar-Qershor 2023

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë i kem dy këshilla, e para të Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, është mire me qen me te kujdesshëm pasi qe ne kuvend disa hera na kanë ardhe disa vendime me gabime e te cilat janë kthyer negativ nga ministria për shkak te gabimit te tyre. Dhe e dyta të sektori i personelit ku qe disa here po dëmtohem me ne paga për shkak te gabimit te tyre. Po ashtu kur po i shpallin konkurset po ka shumë gabime teknike dhe qe disa konkurse po anulohet për shkak te gabimit te tyre.

Lulzim Rustemi, tha se ky raport do te ishte mire qe ta diskutojmë me shume ne fund te vitit. Sa i përket këtij raporti do te ndalem me shumë te Arsimi ku kemi ne disa shkolla nxënës ta pa notuar dhe, ka nxënës qe kane ndërpre mësimin, por edhe shume nxënës me mungesa pa arsye . Po ashtu shumë nxënës kemi me sukses te mjaftueshme dhe kjo është alarmante. Kemi edhe nxënës ta pa notuar. Po ashtu ne disa shkolla edhe testi i arritshme risë është jo i mire, si dhe te shkolla Adem Gllavica testi kombëtar keq. Ne Arsim ka shume pune dhe duhet te behet një kthese e madhe. Po ashtu punësimit është duke u bere pa kriter ne arsim, dhe po shihen rezultatet. Arsimi është një nder sfidat me te mëdha te shoqërisë. Te kultura rinia dhe sporti duhet ti kushtohet me shume rendësi sportit.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:45.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi